**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA HAS**
**FINANCA**

Nr. 3077/1 Prot. Date 18/08/2026.

**Lenda :** Relacion për Projekt Vendimin Nr.13 "Për një shtesë fondesh në buxhetin e bashkisë has për vitin 2026, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit me UNDP për projektin 'Askush të mos mbetet pas / Leave no one behind"

**Drejtuar:** Këshillit Bashkiak Has

Bazuar në, Ligjin Nr.139/2015, date 17.12.2015 "Për Veteqeverisjen Vendore", Ligjin Nr.68/2017 "Per Financat e Veteqeverisjes Vendore", Ligjin Nr.9936, date 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, Ligjit Nr. 87/2025 per buxhetin e vitit 2026", Udhëzimit Plotësues Nr.2 datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit 2026", është përgatitur Projektvendimi për miratimin e shtesës së fondeve në Buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2026.

Qëllimi i këtij Projektvendimi është pasqyrimi në Buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2026 i fondeve të përfituara në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me UNDP, për zbatimin e projektit "Askush të mos mbetet pas / Leave No One Behind".

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, Bashkia Has përfiton fonde në shumën totale 2,179,234 lekë, të cilat do të përdoren për financimin e aktiviteteve dhe shpenzimeve të përcaktuara në projekt.

**FONDET E PËRFITUARA**

Në Buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2026 propozohet të shtohet shuma: 2,179,234 lekë *(dy milionë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e tridhjetë e katër lekë)*.

Burimi i financimit për këtë shtesë janë fondet e përfituara nga UNDP, në kuadër të projektit "Askush të mos mbetet pas / Leave No One Behind".

**SHPËRNDARJA E FONDEVE**

Fondet shtesë do të pasqyrohen në Programin 10430 – Përkujdesja sociale, sipas strukturës së mëposhtme:

| Gr | Kapitulli | Programi | Llogari ekonomike | Shuma | Emertimi i shpenzimit |
|---|---|---|---|---|---|
| 00 | 05 | 10430 | 2312104 | 2,154,234 | Rikonstruksioni i Qendres |
| 00 | 05 | 10430 | 6020900 | 25,000 | Furnizime (Blerje mjetesh per qendren) |
| **Totali transfertës** | | | | **2,179,234** | |

Kështu, nga fondi total i përfituar, 2,154,234 lekë do të përdoren për rikonstruksionin e qendrës, ndërsa 25,000 lekë do të përdoren për furnizime, konkretisht për blerjen e mjeteve për qendrën.

Miratimi i këtij Projektvendimi është i nevojshëm për të mundësuar pasqyrimin dhe përdorimin e fondeve të përfituara nga UNDP në Buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2026, në përputhje me qëllimin dhe aktivitetet e përcaktuara në kuadër të projektit "Askush të mos mbetet pas / Leave No One Behind".

Për sa më sipër, duke marrë në konsideratë fondet e përfituara nga UNDP dhe nevojën për reflektimin e tyre në Buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2026, propozohet që Këshilli Bashkiak Has të shqyrtojë dhe të miratojë Projektvendimin Nr. 13 "Për një shtesë fondesh në Buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2026", në shumën totale 2,179,234 lekë.

**KRYETAR**

Miftar DAUTI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

**Përgjegjëse Finance**

Grislanda Bajraktari